



Qeveria e Kosovës ka identifikuar nevojën për kapacitete gjeneruese shtesë që t'i adresojë shqetësimet afatgjatë rreth sigurisë së furnizimit me energji në vend. Synimet e politikave qeveritare kanë për qëllim përfshirjen e sektorit privat në projektin infrastrukturor të Termocentralit Kosova e Re (TCKR) i cili përfshinë zhvillimin, dizajnin, ndërtimin, financimin, pronësinë, mirëmbajtjen dhe operimin në përputhje me IED/BAT. Pas 20 vjet të operimit, bazuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë, pronësia e termocentralit do t'i kalojë Qeverisë, pa kosto.

## Parametrat teknik të TCKR:

<b>Kapaciteti i instaluar:</b> 500 MW (bruto) ose 450 MW (energji elektrike neto)
<b>Efikasiteti neto i termocentralit:</b> > 40%
<b>Faktori i disponueshmërisë:</b> ≥ 90%
<b>Përgatitja për ko-gjenerim:</b> 10% e kapacitetit elektrik, > 200 MW <sub>th</sub>
<b>Jetëgjatësia e dizajnuar e objektit:</b> 40 vjet
<b>Mbrojtja e mjedisit:</b> sipas IED/BAT
<b>Kapja e karbonit:</b> hapësira e dedikuar në lokacion pranë TCKR
<b>Lokacioni:</b> pranë termocentralit Kosova B
<b>Kyçja në rrjet:</b> KOSTT (Kosova B)
<b>Lënda djegëse kryesore:</b> Linjiti nga miniera Sibovc-jug
<b>Furnizimi me ujë:</b> Sistemi i Ibër-Lepencit

## Vlerat e kufizimit të emetimit të TCKR:

IED/BAT	Kaldaja me shtrat qarkullues të lëngëzuar		Kaldaja me djegie të pluhurizuar	
	Mesatarja vjetore	Mesatarja ditore	Mesatarja vjetore	Mesatarja ditore
<b>AEL</b>				
<b>Ndotësi</b>	mg/Nm <sup>3</sup>	mg/Nm <sup>3</sup>	mg/Nm <sup>3</sup>	mg/Nm <sup>3</sup>
SO <sub>2</sub>	20 - 75	25 - 110	10 - 75	25 - 110
NO <sub>x</sub>	50 - 85	80 - 125	65 - 85	80 - 125
Pluhur	2 - 5	3 - 10	2 - 5	3 - 10

Vendimi zbatues i Komisionit (EU) 2017/1442 i datës 31 korrik 2017, për themelimin e teknikave më të mira ekzistuese (BAT), në kuadër të Direktivës 2010/75/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, për impiantet e mëdha me djegie.

Termocentrali Kosova e Re do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm me energji si parakusht për investime të ardhshme që do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Gjatë fazës së ndërtimit do të krijohen mundësi të reja direkte punësimi ndërsa gjatë operimit do të sigurojë vende pune afatgjatë.

## Etapat kryesore të projektit:

<b>2006</b>	Ftesa për Shprehje të Interesit
<b>2014</b>	Kërkesa për Propozime
<b>2015</b>	Përzgjedhja e Ofertuesit të Preferuar
<b>2017</b>	Përmbyllja Komerciale
<b>2018</b>	Prokurimi i kontraktuesit IPN/MAGj
<b>2019</b>	Përmbyllja Financiare / Data e transferit të lokacionit
<b>2019</b>	Data e fillimit të ndërtimit
<b>2023</b>	Data e operimit komercial
<b>2043</b>	Bartja e pronësisë së termocentralit tek QeK

## Marrëveshjet e projektit:

Marrëveshja e implementimit	QeK / GenCo
Marrëveshja e transferit të lokacionit	GenCo / KEK
Marrëveshja e mbështetjes nga sponsorët	GenCo / QeK
Marrëveshja për blerjen e energjisë	GenCo / QeK
Marrëveshja e furnizimit me linjit	GenCo / KEK
Marrëveshja e furnizimit me ujë	GenCo / Ibër-Lepenci
Marrëveshja për kyçje në rrjet	GenCo / KOSTT
Marrëveshja për deponimin e hirit dhe gipsit	GenCo / KEK

Në vitin 2015, Qeveria e Kosovës i ka dhënë ContourGlobal (CG) statusin e Ofertuesit të Preferuar për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re. CG-ja është kompani nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e specializuar në blerjen dhe zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese bazuar në kontrata afatgjate, me lloje të ndryshme të lëndëve djegëse si dhe lokacione të ndryshme gjeografike. CG-ja do të ofrojë 30% të koston së përgjithshme të projektit përmes zotimeve të kapitalit (ekuitetit) në nivel të projektit dhe do të jetë përgjegjëse për të aranzuar financimin përmes kredive.